

BYRN

BALKAN
INVESTIGATIVE
REPORTING
NETWORK | ALBANIA



MONITORIMI I

NIVELIT TË

TRANSPARENCËS SË

GJYKATAVE NË SHQIPËRI

MONITORIMI I NIVELIT TË TRANSPARENCËS SË GJYKATAVE NË SHQIPËRI

Tiranë, 2018

Publikuar nga: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri – BIRN Albania
Blv. Gjergj Fishta, Nr. 5/22, Tiranë, Shqipëri
<http://birn.eu.com/>

Përgjegjës: Kristina Voko

Monitorimi u krye nga: Anila Dushi, Bashkim Shala, Hysen Likdisha, Elvis Hila, Gëzim Kabashi,
Besar Likmeta, Fatbardha Nergjoni, Edmond Hoxhaj, Eriola Azizolli,
Raimond Kola, Dhorjela Cule dhe Elton Qyno.

Kontribuoi: Ardita Shehaj

Grafika: Jurgena Tahiri

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri
Tiranë, 2018



Raporti u realizua me mbështetjen e Projektit të USAID-it Drejtësi për të Gjithë. Brendia e tij është përgjegjësi e vetme e Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Investigative në Shqipëri – BIRN Albania dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Përmbajtja:

7

Hyrje

8

Qëllimi dhe metodologjia e monitorimit

12

Gjetjet e monitorimit

15

Renditja e secilës gjykatë

54

Konkluzione dhe rekomandime

57

Aneksi I: Metodologjia e detajuar

1. Hyrje

Transparenca e proceseve gjyqësore dhe gjykatave si dhe aksesit i publikut janë elemente thelbësore për nxitjen e llogaridhënies dhe rritjen e besimit ndaj sistemit gjyqësor. Keta elementë marrin një dimension edhe më të rëndësishëm në momentin kur sistemi gjyqësor në Shqipëri është përfshirë në një reformë të thellë që ka për qëllim çlirimin e tij nga korrupsion dhe rritjen e pavarësisë nga ndikimi politik. Për të arritur këto qëllime, transparenca është njohur si dimension i rëndësishëm edhe nga Raporti analitik i sistemit të drejtësisë në Shqipëri¹ për gatitur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, i cili nënvizon se “publiciteti i veprimtarisë gjyqësore, aksesit i publikut në drejtësi dhe hapja e kësaj veprimtarie ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun janë elemente themelore për një sistem gjyqësor transparent”. Sipas ekspertëve, transparenca e gjyqësorit është një karakteristikë e sistemeve demokratike dhe ndihmon parimin kushtetues të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.

Transparenca e institucioneve gjyqësore mundet të kontribuojë në rritjen e pavarësisë së sistemit gjyqësor, i cili është një aktor kyç për konsolidimin e sundimit të ligjit. Gjithashtu, aksesit në informacionin e prodhuar nga gjykatat shërben për të rritur besimin e qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë, por dhe pushtetit në përgjithësi.

Vlen të theksohet se transparenca në sistemin gjyqësor mund të sigurohet nëpërmjet Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, por edhe nëpërmjet legjislacionit që rregullon këtë sektor. Në kuptim të pikës 1 të nenit 2 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” autoritet publik është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj. Pra referuar këtij përkufizimi, Gjykatat vlerësohen si autoritete publike dhe si të tilla duhet të zbatojnë të gjitha detyrimet që burojnë nga ky ligj. Duke filluar që nga detyrimi për të kthyer përgjigje qytetarëve brenda 10 ditë pune, argumentimi i rasteve kur refuzohet dhënia e informacionit dhe më e rëndësishmja publikimi i programeve të transparencës në faqen e internetit.

Por transparenca e sistemit gjyqësor sigurohet dhe nëpërmjet legjislacionit specifik që rregullon këtë sektor si Kodi i Procedurës Civile, Kodi i procedurës Penale, Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” etj. Në këtë kontekst, transparenca e gjyqësorit bazohet në katër parime themelore ku përfshihen: 1. Parashikimi që seancat të jenë të hapura; 2. Marrja e informacionit mbi seancat gjyqësore dhe vendimit; 3. Aksesit i publikut në informacion; 4. Dixhitalizimi i sistemit.

Seancat gjyqësore duhet të jenë të hapura për publikun, pavarësisht kufizimeve që sjell në këtë drejtim infrastruktura në gjykata. Marrja e informacionit nga seancat gjyqësore, mbi kohën dhe vendin e zhvillimit të tyre si dhe njoftimi i palëve, janë gjithashtu indikatorë të aksesit të publikut në gjyqësor. Një rol në rritjen e aksesit të publikut në gjykata luan dhe dixhitalizimi, nëpërmjet sistemit të regjistrimit audio të seancave RDA, i cili garanton një procesverbal të saktë dhe ndihmon në mënyrë efikase për të bërë transparente seancën gjyqësore. Dixhitalizimi gjithashtu ndihmon për të patur më shumë akses në vendimet gjyqësore si dokumente publike, duke forcuar mekanizmin e llogaridhënies dhe përgjegjshmërinë e gjyqësorit.

Transparenca është kusht për mirëqeverisje dhe mund të arrihet nëpërmjet publikimit proaktiv në faqet e internetit ose në ambiente të caktuara të institucionit informacionet dhe dokumentet publike të prodhuara dhe administruara nga autoritetet publike, përfshirë dhe gjykatat e të gjitha shkallëve.

2. Qëllimi dhe metodologjia e monitorimit

Transparenca proaktive është e rëndësishme sepse informacioni mund të shpërndahet lehtësisht dhe nëpërmjet disa rrugëve të komunikimit si p.sh., nëpërmjet internetit, medias, afishimit në stenda, publikimit të buletineve informuese, etj. Në këtë mënyrë informacioni mund të aksesohet nga shumë njerëz njëkohësisht. Përmes publikimit online, institucionet mund të përditësojnë lehtësisht informacionin e vënë në dispozicion. Transparenca proaktive i shërben institucioneve, për të reduktuar numrin e kërkesave për informacion si dhe për të fituar besimin e qytetarëve.

Bazuar mbi çfarë është shkruar më sipër, ky monitorim ka për qëllim vlerësimin e transparencës së të gjithë gjykatave në vend lidhur me kategoritë e informacionit që këto institucione bëjnë publike përmes rrugëve të ndryshme të komunikimit me qytetarët. Gjetjet e këtij monitorimi synojnë të nxisin më tej vullnetin dhe gatishmërinë e institucioneve të pushtetit gjyqësor për të rritur nivelin e transparencës, duke shërbyer edhe si një studim bazë për vlerësime të mëtejshme të ecurisë së këtij procesi.

Për këtë arsye, të 38 gjykatat e vendit dhe Gjykata Kushtetuese janë monitoruar lidhur me publikimin e 36 indikatorëve që rrjedhin nga kuadri rregullator në fuqi. Në mënyrë që informacioni i mbledhur të ishte sa më gjithëpërfshirës, monitorimi u realizua duke kombinuar tre metoda të ndryshme të mbledhjes së të dhënave: a) monitorimi në terren pranë secilës gjykatë; b) monitorimi online përmes faqeve të internetit që gjykatat përdorin; c) përmes kërkesave për të drejtë informimi të dërguara pranë tyre. Monitorimi në terren u krye nga 12 gazetarë të trajnuar, ndërsa monitorimi online dhe ai përmes kërkesave për të drejtën e informimit u realizua nga stafi i BIRN ALBANIA.

Në mënyrë që informacioni dhe rezultatet e këtij monitorimi të jenë sa më lehtësisht të kuptueshme dhe të krahasueshme mes gjykatave të monitoruara, 36 indikatorët e identifikuar të nivelit të përgjithshëm të transparencës u ndanë në gjashtë kategori kryesore: 1. Aksesimi në gjykata; 2. Çështjet dhe vendimet gjyqësore; 3. Informacion për publikun; 4. Organizimi i brendshëm; 5. Transparenca financiare; 6. E drejta e informimit. Listën e plotë të indikatorëve dhe ndarjen përkatëse në secilën kategori e gjeni në Tabelën 1.

Tabela 1: Indikatorët përbërës të secilës kategori të nivelit të transparencës.



AKSESI NË GJYKATA

Aksesi fizik në ambientet e gjykatës

Formulari për video-regjistrimin nga ana e gazetareve

Formulari i kërkesës së regjistrimit audio

Kopje vendimi gjyqësor

Kopje transkriptimi ose regjistrimi audio i një seance gjyqësore

Leje për ndjekjen dhe regjistrimin e seancave



**ÇËSHJTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE**

Publikimi i vendimeve të gjykatës

Publikimi i listës së çështjeve në gjykim

Publikimi i kalendarit të seancave gjyqësore

Përmbledhje e ecurisë së çështjeve dhe kronologjisë së tyre

Statistika mbi çështjet / Evidenca statistikore



INFORMACIONE PËR PUBLIKUN

Publikimin e njoftimeve me afishim publik

Listën e tarifave të shërbimeve që ofron gjykata

Të drejtat e qytetarëve dhe orientimi në gjykata

Adresa e gjykatës dhe mundësia për kontaktimi

Listën emërore të avokatëve, ekspertëve dhe ndërmjetësve të gjykatës



ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Struktura organizative/ organograma e gjykatës

Funksionet dhe detyrat e funksionarëve të gjykatës

Listën emërore të gjyqtarëve

Strukturat e pagave të stafit të gjykatës

Rregulloret e miratuara dhe në fuqi të gjykatës

Raportin vjetor të gjykatës për vitin më të fundit të analizuar

CV/ Biografite të funksionarëve të lartë ...

Kuadrin rregullator në fuqi mbi të cilat bazohet funksionimi



TRANSPARENCA FINANCIARE

Buxheti i vitit aktual

Raportin e monitorimit të shpenzimeve për vitin më të fundit financiar të analizuar

Raporti i fundit i auditimit të brendshëm

Raport i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose organe të tjera mbikqyrëse (nëse ka)

Lista e kontratave të lidhura momentalisht me palë të treta (shërbime të kontraktuara ose tenderuara)

Informacione mbi shumën e kontraktuar, palët kontraktuese, përshkrimi i mallrave ose shërbimeve të kontraktuara, plan zbatimi (afate kohore) dhe monitorimi të tyre.



E DREJTA E
INFORMIMIT

Programi i transparencës së gjykatës

Koordinatori i të të drejtës së informimit

Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit

Formati i kërkesës për informim

Formati i ankimit të vendimit përkatës për informacionin e kërkuar


Regjistri i kërkesave për të drejtën e informimit dhe përgjigjeve ndaj tyre

Gjithashtu, rezultatet e këtij monitorimi prezantohen bazuar në përqindjen e përmbushjes së nivelit të transparencës në tërësi, por dhe për secilën kategori indikatorësh. Përqindjet janë përlogaritur në bazë të pikëzimit të marrë gjatë monitorimit nga secila gjykatë për indikatorin përkatës, si dhe peshës specifike të çdo indikatorit. Për të mësuar më shumë detaje rreth metodologjisë dhe hapave specifike që u ndoqën, referojuni Aneksit I të këtij raporti 'Metodologjia e detajuar'.

Për të lehtësuar vizualizimin e gjetjeve, përqindjet janë shoqëruar dhe me ngjyrimet përkatëse, sipas Infografikës së mëposhtme:


Niveli i Transparencës

0% - 40%



Niveli i Transparencës

41%-80%




Niveli i Transparencës

81%-100%



3. Gjetjet e monitorimit

Gjetjet e këtij monitorimi të parë lidhur me shkallën e transparencës së gjykatave të të gjitha niveleve në vend, tregojnë se shumica e këtyre institucioneve publike kanë dështuar në përmbushjen e të paktën gjysmës së 36 indikatorëve të vërtetuar. Ashtu siç dallohet dhe nga Infografika e mëposhtme, niveli mesatar i transparencës për të 39 institucionet e monitoruar është vetëm 48%, duke shfaqur dallime të ndjeshme mes kategorive të ndryshme të indikatorëve.



Gjetjet e mësipërme tregojnë se gjykatat janë më transparente lidhur me indikatorët që përfshihen në kategoritë “Aksesi në gjykata” dhe “Çështjet dhe vendimet gjyqësore”, ndërsa kategoritë të cilat janë më pak transparente në nivel kombëtar janë “Transparenca financiare” dhe “Organizimi i brendshëm”.

Gjithashtu, gjatë leximit të gjetjeve të këtij monitorimi duhet pasur parasysh që vlerësimi është rezultat akumulativ i të tre metodave të ndryshme të monitorimit të përdorur. Kjo do të thotë se nëse monitorimi i përmbushjes së indikatorëve të transparencës proaktive do të realizohej vetëm përmes mbledhjes së të dhënave me një metodë të vetme, rezultatet e arritura do të ishin edhe më të ulëta. Kështu, duke qenë se detyrimet kryesore të publikimit të informacionit dhe dokumenteve publikë të parashikuar nga kuadri rregullator duhet të publikohen në faqet e internetit, nëse monitorimi do të kishte marrë parasysh vetëm gjetjet e vëzhgimit online, kategoria “Transparenca financiare” do të mblidhte gjithsej vetëm 12% të pikëve maksimale, duke mos u dhënë shumicës së qytetarëve të drejtën të kenë akses të barabartë në informacionin publik në rastet kur nuk dërgojnë kërkesë të drejte për informim për mbledhjen e tij.

Në mënyrë që gjetjet e këtij monitorimi të lexohen më lehtë, por dhe të shërbejnë si shtysë për rritjen e transparencës ndër gjykatat e vendit, më poshtë prezantohen rezultatet e vlerësimit të nivelit të përgjithshëm të transparencës për çdo gjykatë, duke nisur nga gjykata që është më e hapur, deri tek ajo që është më pak e hapur ndaj qytetarëve.

Rezultatet e detajuara për secilën gjykatë mbi të gjitha kategoritë e përfshira në monitorim, prezantohen në seksionin në vazhdim.

Tabela 2: Renditja e gjykatave sipas nivelit të transparencës, duke filluar nga rezultati më pozitiv në atë më negativ.

#	Gjykata	Niveli i Transparencës
1	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë	63%
2	Gjykata e Lartë	62%
3	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë	62%
4	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës	60%
5	Gjykata Administrative e Apelit	58%
6	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat	57%
7	Gjykata Administrative Shkodër	56%
8	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë	56%
9	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë	56%
10	Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda	56%
11	Gjykata e Apelit Korçë	53%
12	Gjykata e Apelit Shkodër	52%
13	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër	52%
14	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë	52%
15	Gjykata Administrative Vlorë	52%
16	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier	52%
17	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet	51%
18	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë	51%
19	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	50%

20	Gjykata Kushtetuese	48%
21	Gjykata Administrative Gjirokastrë	47%
22	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër	47%
23	Gjykata e Apelit Gjirokastrë	46%
24	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec	44%
25	Gjykata e Apelit për Krime të Rënda	44%
26	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan	43%
27	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë	42%
28	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë	41%
29	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë	41%
30	Gjykata Administrative Tiranë	40%
31	Gjykata e Apelit Durrës	40%
32	Gjykata e Apelit Tiranë	39%
33	Gjykata Administrative Korçë	39%
34	Gjykata e Apelit Vlorë	38%
35	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës	38%
36	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat	38%
37	Gjykata Administrative Durrës	38%
38	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë	36%
39	Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin	36%



Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë

#1




NIVELI I TRANSPARENCËS


63%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Lartë

#2




NIVELI I TRANSPARENCËS


62%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë

#3




NIVELI I TRANSPARENCËS


62%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës

#4




NIVELI I TRANSPARENCËS


60%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata Administrative e Apelit

#5




NIVELI I TRANSPARENCËS


58%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat

#6




NIVELI I TRANSPARENCËS


57%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata Administrative Shkodër

#7




NIVELI I TRANSPARENCËS


56%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

#8




NIVELI I TRANSPARENCËS


56%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR PUBLIKUN




ORGANIZIMI I BRENDSHËM



TRANSPARENCA FINANCIARE



E DREJTA E INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë

#9




NIVELI I TRANSPARENCËS


56%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda

#10




NIVELI I TRANSPARENCËS


56%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR PUBLIKUN




ORGANIZIMI I BRENDSHËM



TRANSPARENCA FINANCIARE



E DREJTA E INFORMIMIT





Gjykata e Apelit Korçë

#11




NIVELI I TRANSPARENCËS


53%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Apelit Shkodër

#12




NIVELI I TRANSPARENCËS


52%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër

#13




NIVELI I TRANSPARENCËS


52%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë

#14




NIVELI I TRANSPARENCËS


52%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata Administrative Vlorë

#15




NIVELI I TRANSPARENCËS


52%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN



ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier

#16




NIVELI I TRANSPARENCËS


52%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet

#17




NIVELI I TRANSPARENCËS


51%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë

#18




NIVELI I TRANSPARENCËS


51%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR PUBLIKUN




ORGANIZIMI I BRENDSHËM



TRANSPARENCA FINANCIARE



E DREJTA E INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë

#19




NIVELI I TRANSPARENCËS


50%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata Kushtetuese

#20




NIVELI I TRANSPRENCËS


48%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata Administrative Gjirokastrër

#21




NIVELI I TRANSPARENCËS


47%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

#22




NIVELI I TRANSPARENCËS


47%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Apelit Gjirokastër

#23



NIVELI I TRANSPARENCËS

46%



AKSESI NË GJYKATA

44%



ÇËSHTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE

52%



INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN

41%



ORGANIZIMI I
BRENDSHËM

45%



TRANSPARENCA
FINANCIARE

33%



E DREJTA E
INFORMIMIT

52%



Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec

#24




NIVELI I TRANSPARENCËS


44%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR PUBLIKUN




ORGANIZIMI I BRENDSHËM



TRANSPARENCA FINANCIARE



E DREJTA E INFORMIMIT





Gjykata e Apelit për Krime të Rënda

#25




NIVELI I TRANSPARENCËS


44%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan

#26




NIVELI I TRANSPARENCËS


43%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

#27




NIVELI I TRANSPARENCËS


42%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë

#28




NIVELI I TRANSPARENCËS


41%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë

#29




NIVELI I TRANSPARENCËS


41%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata Administrative Tiranë

#30




NIVELI I TRANSPARENCËS


40%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Apelit Durrës

#31




NIVELI I TRANSPARENCËS


40%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Apelit Tiranë

#32




NIVELI I TRANSPARENCËS


39%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata Administrative Korçë

#33




NIVELI I TRANSPARENCËS


39%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Apelit Vlorë

#34




NIVELI I TRANSPARENCËS


38%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR PUBLIKUN




ORGANIZIMI I BRENDSHËM



TRANSPARENCA FINANCIARE



E DREJTA E INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës

#35




NIVELI I TRANSPARENCËS


38%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat

#36




NIVELI I TRANSPARENCËS


38%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata Administrative Durrës

#37




NIVELI I TRANSPARENCËS


38%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë

#38




NIVELI I TRANSPARENCËS


36%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR PUBLIKUN




ORGANIZIMI I BRENDSHËM



TRANSPARENCA FINANCIARE



E DREJTA E INFORMIMIT





Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin

#39




NIVELI I TRANSPARENCËS


36%




AKSESI NË GJYKATA




ÇËSHTJET DHE
VENDIMET GJYQËSORE




INFORMACIONE PËR
PUBLIKUN




ORGANIZIMI I
BRENDSHËM



TRANSPARENCA
FINANCIARE



E DREJTA E
INFORMIMIT



4. Konkluzione dhe rekomandime

Mbështetur në gjetjet e këtij monitorimi të parë të 38 gjykatave dhe Gjykatën Kushtetuese të vendit me synimin e përmirësimit të nivelit të transparencës së tyre ndaj qytetarëve dhe medias, problematikat kryesore të identifikuara përgjatë këtij procesi si dhe rekomandimet përkatëse për secilën prej tyre përmbledhen më poshtë:

- Pavarësisht nivelit të përgjithshëm të pakënaqshëm të transparencës së gjykatave, rezultatet lidhur me kategoritë e ndryshme të informacioneve dhe dokumenteve që këto institucione duhet të publikojnë në mënyrë proaktive tregojnë se gjykatat përqendrohen kryesisht në përmbushjen e detyrimeve për transparencë që rrjedhin nga kuadri rregullator specifik, të tilla si publikimi i vendimeve të çështjeve gjyqësore, kalendarit të seancave dhe listës së çështjeve në gjykim. Pavarësisht rëndësisë të veçantë që ky bllok informacioni publik ka, në nivel kombëtar vihet re një neglizhencë nga ana e gjykatave për përmbushjen e detyrimeve për transparencë proaktive që rrjedhin nga Ligji 119/2014 'Për të Drejtën e Informimit', kryesisht në kategoritë e indikatorëve 'Organizimi i brendshëm', 'Transparenca financiare' dhe 'E drejta e informimit'. Në këtë kuadër, duhet të ketë një ndërgjegjësim më të lartë të këtyre institucioneve mbi detyrimet që ato kanë në llogaridhënie jo vetëm mbi funksionin e tyre specifik, proceset gjyqësore, por edhe me aspektet administrative, të tilla si menaxhimi i buxhetit, publikimi i kontratave të lidhura me palë të treta, organigrama dhe rregulloret e menaxhimit të brendshëm. Për shembull, pothuajse të gjitha gjykatat e vendit nuk kanë publikuar CV-të e funksionarëve të lartë të tyre me pretendimin se gjyqtarët emërohen nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Pavarësisht kësaj specifike, ashtu si dhe për çdo autoritet tjetër publik, përgjegjësia për publikimin e CV-ve të të gjithë funksionarëve publikë që janë subjekt i deklarimit të pasurisë duhet të kryhet nga institucioni pranë të cilit ata kryejnë funksionin, pra vetë gjykatat.

- Pavarësisht se pjesa më e madhe e gjykatave kanë miratuar dhe publikuar një program transparence, në të gjitha rastet programi nuk përmbush detyrimin bazë të parashikuar në Ligjin 119/2014 'Për të Drejtën e Informimit' për të linkuar / përfshirë informacionin e detyrueshëm për publikim brenda versionit elektronik të tij, duke vështirësuar kështu orientimin e qytetarëve në gjetjen e dokumenteve ose informacioneve publike. Për këtë arsye, gjykatat duhet të marrin masa që programi i transparencës të jetë i përditësueshëm dhe të përfshijë në të lidhjet me të gjitha dokumentet ose seksionet e faqeve të internetit ku gjendet informacioni i kërkuar.

- Asnjë nga gjykatat e vendit nuk dispononte një regjistër të përditësuar të kërkesave për të drejtë informimi në të cilin të reflektohen dhe të bashkëlidhen të gjitha përgjigjet që i janë dhënë kërkuarit. Publikimi i përgjigjeve në format elektronik është jo vetëm një detyrim ligjor, por do të mundësonte palët e tjera të interesuara për të njëjtin informacion publik ta aksesonin atë pa pengesa dhe pa kërkesë të posaçme për të drejtë informimi.

- Një nga problematikat kryesore të identifikuar lidhur me përmbushjen e detyrimeve për publikimin e indikatorëve të transparencës proaktive të identifikuar gjatë monitorimit ishin dhe faqet e internetit të përdorura nga gjykatat e vendit. Shumica e gjykatave publikojnë informacionin dhe dokumentet publike vetëm përmes seksioneve të secilës gjykatë brenda portalit <http://www.gjykata.gov.al/>, struktura e të cilave nuk i përgjigjet kërkesave për transparencë dhe marrjes së një informacioni lehtësisht të arritshëm nga qytetarët ose media. Por edhe në rastet kur brenda faqeve janë vendosur rubrika specifike për njoftimet ose rregulloret e gjykatave, dokumentet e afishuara në to nuk përputheshin me përmbajtjen, duke e vështirësuar dhe më tej gjetjen e informacionit të nevojshëm për monitorim.

- Secila nga faqet elektronike të gjykatave u vëzhgua më shumë se një herë gjatë procesit të monitorimit online, pasi databazat e përfshira në faqet ekzistuese paraqisnin shpeshherë probleme teknike, duke mos bërë të mundur gjetjen e informacionit të kërkuar. Ndër seksionet më problematike të faqeve të internetit lidheshin me prodhimet e raporteve mbi vendimet gjyqësore të muajve të kaluar, kalendarin e seancave në ditët në vijim, si dhe detajet e çështjeve nën shqyrtim.

- Tetë nga gjykatat në vend disponojnë edhe faqet e tyre të pavaruara elektronike, përveç seksionit të dedikuar pranë portalit <http://www.gjykata.gov.al/>, me përjashtim të Gjykatës Kushtetuese e cila përdor për publikim vetëm faqen e saj të posaçme. Në këto raste, gjatë monitorimit online janë marrë parasysh informacionet dhe dokumentet e publikuar në të dy adresat elektronike, duke qenë se pavarësisht faqeve të posaçme, një pjesë e informacionit lidhur me kalendarin e çështjeve dhe vendimet e gjykatës vazhdojnë të jenë më të përditësuara në portalin qendror. Informacionet e publikuara paralelisht në dy faqe të ndryshme interneti nuk bëjnë gjë tjetër veçse ç'orientojnë qytetarët e interesuar në marrjen e informacionit ose vonesa në kërkimet e tyre në internet. Për këtë arsye rekomandohet që gjykatat të kenë një identitet të vetëm institucional në internet, ku të publikohen të gjithë dokumentet e tyre zyrtare.

- Ashtu siç shpjegohet në detaje dhe në seksionin e metodologjisë së këtij raporti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së indikatorëve ishte dhe vëzhgimi i përdorimit të anonimizimit të çështjeve dhe vendimeve gjyqësore në faqet elektronike të gjykatave, me fokus të veçantë në monitorimin e çështjeve penale me interes publik. Nga monitorimi vihet re se praktikat e anonimizimit të kalendarit të seancave, listës së çështjeve për gjykim dhe vendimeve gjyqësore përdoret nga rreth një e treta e gjykatave në vend, duke identifikuar mungesën e një kuadri rregullator të qartë në këtë fushë. Gjithashtu, dhe në rastet kur gjykatat i publikojnë informacionet e mësipërme të anonimizuara, vihet re mungesa e praktikave unifikuese ose vlerësim i arsyeve që diktojnë mbrojtjen e të dhënave personale. Nga njëra anë, disa gjykata anonimizojnë vendimet lidhur me të dhënat personale, por jo përmbledhjen ose detajet e çështjes në sistem duke i bërë lehtësisht të identifikueshëm individët, kurse nga ana tjetër, disa gjykata anonimizojnë dhe të dhënat e përgjithshme të institucioneve ligjzbatuese, të tilla si rrethi gjyqësor i prokurorisë, etj. Për këtë arsye, gjykatat dhe institucionet e tjera

të drejtësisë duhet të zhvillojnë një debat të gjerë konsultues me të gjithë palët e interesuara, përfshirë dhe median, mbi procesin e anonimizimit të informacionit, mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe kufijve të kësaj të drejte ndaj interesit publik për informim.

- Ndër 39 institucionet e monitoruara, në të shumtën e rasteve gjykatat nuk kanë hartuar ose publikuar rregulla ose udhëzime të qarta lidhur me marrëdhëniet me publikun dhe mediat. Dhe në ato raste kur gjykatat kanë publikuar udhëzues të tillë, sërish zbatimi i tyre lë shumë për të dëshiruar në praktikë. Një shembull konkret lidhet me mungesën e formularëve të posaçëm për video-regjistrimin nga ana e gazetarëve të seancave gjyqësore ose për kërkesën e regjistrimit audio nga sistemi RDA. Pavarësisht se këta formularë janë miratuar dhe disa herë edhe publikuar në faqet e internetit, ata nuk janë shumëfishuar dhe nuk vihen në dispozicion të qytetarëve ose gazetarëve.

- Edhe gjatë monitorimit në terren u vu re mungesa e zbatimit të procedurave të parashikuara në udhëzuesit e hartuar lidhur me sistemin RDA ose kërkesën për ndjekjen e seancave gjyqësore. Për shembull, pavarësisht se të gjithë gazetarët e përfshirë në monitorimin në terren kanë dorëzuar kërkesa specifike për ndjekjen e një seance gjyqësore me interes publik sipas procedurave të parashikuara, në shumicën e rasteve kërkesa e tyre nuk është trajtuar brenda afateve kohore ose nuk u është referuar vendimi përkatës gjatë seancës nga gjyqtari përgjegjës. Në këtë kontekst, gjykatat rekomandohen të hartojnë ose përditësojnë udhëzuesit dhe rregulloret e marrëdhënieve me publikun dhe median, duke përfshirë në to formatet e kërkesave, hapat që duhet të ndiqen nga palët, si dhe afatet kohore të parashikuara dhe t'i kushtojnë vëmendje të veçantë zbatimit me korrektësi të tyre.

- Në shumicën e gjykatave mungon ende pozicioni i koordinatorit të marrëdhënieve me publikun, ndërsa ai i koordinatorit për të drejtën e informimit kryhet nga personeli IT ose nga kancelari. Mungesa e personelit të dedikuar ndaj këtyre dy detyrave të rëndësishme sjell për rrjedhojë vështirësi në komunikimin e qytetarëve ose të gazetarëve me gjykatat, si dhe orientimin e tyre të duhur brenda ambienteve të saj. Gjithashtu, në shumë raste, për shkak të kufizimeve të aksesit fizik në ambientet e gjykatës, qytetarët ose gazetarët nuk mund të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me këta funksionarë, duke u bërë pengesë për aksesin në informacionin publik. Për këtë arsye, të gjitha gjykatat duhet të zhvillojnë një debat të gjerë konsultues me të gjithë palët e interesuara, përfshirë dhe median, për përcaktimin e roleve të qarta lidhur me të drejtën e informimit dhe marrëdhënien me publikun dhe median, si dhe ngritjen e kapaciteteve të këtyre funksionarëve, duke marrë parasysh dhe parashikimet më të fundit ligjore për rolin e magjistratit të marrëdhënies me publikun dhe median.

ANEKSI I

Metodologjia e detajuar

Ky monitorim ka për qëllim vlerësimin e transparencës së gjykatave lidhur me kategoritë e informacionit që këto institucione bëjnë publike në bazë të parashikimeve të kuadrit rregullator. Për këtë arsye, të 38 gjykatat e vendit dhe Gjykata Kushtetuese janë monitoruar lidhur me publikimin e 36 indikatorëve të organizuar në 6 kategori kryesore informacioni. Monitorimi në terren u realizua nga 12 gazetarë të trajnuar, ndërsa monitorimi online dhe përmes kërkesave për të drejtë informimi nga stafi i BIRN Albania. Monitorimi u zhvillua gjatë periudhës kohore Shkurt – Prill, 2018.

Hapat e ndjekur për hartimin e metodologjisë së këtij monitorimi janë:

Identifikimi i Indikatorëve: Duke qenë se ky është monitorimi i parë i këtij lloji, ekipit të ekspertëve të përfshirë në këtë vlerësim i lindi detyra që të detajonin dhe përshtatnin detyrimet që rrjedhin për publikim informacioni pa kërkesë për gjykatat nga Ligji 119/2014 ‘Për të Drejtën e Informimit’, por dhe legjislacionit specifik që rregullon këtë sektor, duke identifikuar një set prej 36 indikatorësh. Në mënyrë më të detajuar, indikatorët e përfshirë në kategoritë ‘Organizimi i brendshëm’, ‘Transparenca financiare’ dhe ‘E drejta e informimit’ u identifikuan duke u analizuar nenin 7 i Ligjit 119/2014 ‘Për të Drejtën e Informimit’ mbi kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë, ndërsa indikatorët e përfshirë në kategoritë ‘Aksesi në gjykata’, ‘Çështjet dhe vendimet gjyqësore’ dhe ‘Informacion për publikun’ i referohen detyrimeve që rrjedhin kryesisht nga kuadri rregullator specifik.

Kategorizimi i Indikatorëve: Në mënyrë që informacioni dhe rezultatet e këtij monitorimi të jenë sa më lehtë të kuptueshme dhe të krahasueshme mes gjykatave, të 36 indikatorët e identifikuar të nivelit të transparencës u ndanë në gjashtë kategori kryesore: Aksesi në gjykata; Çështjet dhe vendimet gjyqësore; Informacion për publikun; Organizimi i brendshëm; Transparenca financiare; dhe E drejta e informimit. Listën e plotë të indikatorëve dhe ndarjen përkatëse në secilën kategori e gjeni në Tabelën 4.

Vlerësimi i Indikatorëve: Në mënyrë që informacioni i mbledhur të ishte sa më gjithëpërfshirës, vlerësimi i indikatorëve u realizua duke kombinuar tre metoda të ndryshme të mbledhjes së të dhënave: monitorimi në terren pranë secilës gjykatë; monitorimi online përmes faqeve të internetit që gjykatat përdorin; si dhe përmes kërkesave për të drejtë informimi të dërguara pranë tyre. Procedura e vlerësimit dhe pikëzimit të indikatorëve përmban disa hapa:

1. Përmes *vëzhgimit në internet*, monitoruesit identifikuan të gjitha faqet ekzistuese të përdorura nga gjykatat për publikimin e dokumenteve ose njoftimeve zyrtare. Pas identifikimit të të gjithë faqeve zyrtare (përfshirë faqet në rrjetet sociale), u vlerësua niveli i përditësimit të informacionit brenda tyre, duke qenë se disa nga gjykatat e vendit publikojnë informacionin zyrtar përmes faqeve specifike (të ngritura dhe menaxhuara nga vetë institucioni) dhe seksioneve përkatëse të faqes qendrore të menaxhuar nga Ministria e Drejtësisë <http://www.gjykata.gov.al/>. Faqet aktive të gjykatave iu nënshtruan një vlerësimi të detajuar lidhur me publikimin e 32 indikatorëve të identifikuar të transparencës proaktive, ndërkohë që 4 indikatorët e mbetur (Aksesi fizik në ambientet e gjykatës; Kopje vendimi gjyqësor; Kopje transkriptimi ose regjistrimi audio i një seance gjyqësore; dhe Leje për ndjekjen dhe regjistrimin e seancave) u monitoruan vetëm në terren ose përmes kërkesave për të drejtë informimi. Në rast se informacioni ose dokumenti i indikatorit është publikuar në faqen e internetit dhe mund të aksesohet plotësisht përmes programit të transparencës së hartuar nga gjykata, atëherë transparenca e këtij indikator vlerësohet me 6 pikë. Nëse informacioni ose dokumenti i indikatorit është publikuar në faqen e internetit por nuk mund të aksesohet përmes programit të transparencës sipas kërkesave ligjore (nuk është linkuar brenda fushave përkatëse), transparenca e indikatorit vlerësohet me 4 pikë. Në rastet kur informacioni ose dokumenti i indikatorit është publikuar në mënyrë të pjesshme në faqen e internetit, transparenca e indikatorit vlerësohet me 2 pikë. Në rastet kur informacioni ose dokumenti i indikatorit nuk është publikuar në faqe, transparenca e indikatorit vlerësohet me 0 pikë (shiko Tabelën 3).
2. Përmes *vëzhgimit në terren*, monitoruesit vlerësuan disa nga indikatorët e bërë publik (afishuar ose shumëfishuar) nga vetë institucioni, pranë stendave të posaçme për informimin publik ose pranë ambienteve të jashtme dhe të brendshme të secilës gjykatë, të tilla si publikimi i kalendarit, njoftimeve me afishim publik, formatet e kërkesave për informacion, regjistrimet video të seancave ose për ndjekjen dhe regjistrimin video nga ana e vetë gazetarëve, etj. Gjithashtu, një indikator tjetër i vlerësuar në terren ishte ai i aksesit fizik në ambientet e gjykatave dhe mundësia e kontaktimit të koordinatorit për informim ose të marrëdhënieve me publikun. Në rast se informacioni ose dokumenti i indikatorit mund të aksesohet plotësisht pranë ambienteve të gjykatës, por ai nuk është publikuar online, atëherë transparenca e këtij indikator vlerësohet me 4 pikë. Nëse informacioni ose dokumenti i indikatorit mund të aksesohet në mënyrë të pjesshme ose vetëm pas kërkesës specifike ndaj koordinatorit të të drejtës së informimit ose të marrëdhënieve me publikun, transparenca e indikatorit vlerësohet me 2 pikë. Në rastet kur informacioni ose dokumenti i indikatorit nuk është përmbushur ose në rastet kur informacioni ose dokumenti ekziston por refuzohet të bëhet publik, transparenca e indikatorit vlerësohet me 0 pikë (shiko Tabelën 3). I vetmi indikator i përzgjedhur i cili u monitorua vetëm në terren, Aksesi fizik në gjykata, u vlerësua me pikët maksimale (0-6 pikë) vetëm nga vëzhgimet në terren.

3. Përmes *kërkesave për të drejtë informimi*, monitoruesit i kërkuan gjykatave dy kategori informacionesh.
- A) Në kategorinë e parë, secilës gjykatë iu kërkuan dokumentet dhe informacionet publike që lidhen me indikatorët që rrjedhin nga Ligji 119/2014 'Për të Drejtën e Informimit', të tillë që lidhen kryesisht me kategoritë 'Organizimi i brendshëm', 'Transparenca Financiare' dhe 'E drejta e informimit'. Në rastet kur informacioni ose dokumenti i indikatorit dërgohet i plotë përmes kërkesës për të drejtë informimi, por ai nuk është publikuar online, atëherë transparenca e këtij indikatorit vlerësohet me 2 pikë, ndërsa kur dërgohet në mënyrë të pjesshme ai vlerësohet me 1 pikë. Në rastet kur informacioni ose dokumenti i indikatorit nuk ekziston ose në rastet kur informacioni ose dokumenti ekziston po refuzohet të bëhet publik, transparenca e indikatorit vlerësohet me 0 pikë. B) Në kategorinë e dytë, secilës gjykatë iu dërguan nga gazetarët lokalë tre kërkesa të ndryshme: një kërkesë për marrjen e një vendimi lidhur me një çështje gjyqësore të mbyllur me interes të lartë publik; një kërkesë lidhur me marrjen e transkriptimit ose regjistrimit audio të kryer nga gjykata përmes sistemit RDA për një seancë gjyqësore të një çështjeje me interes të lartë publik; dhe një kërkesë të dorëzuar të paktën 24 orë përpara zhvillimit të një seance gjyqësore me interes të lartë publik mbi mundësinë e pjesëmarrjes dhe regjistrimit video/audio të saj nga ana e gazetarëve. Përmbushja e këtyre tre indikatorëve (Kopje vendimi gjyqësor; Kopje transkriptimi ose regjistrimi audio i një seance gjyqësore; dhe Leje për ndjekjen dhe regjistrimin e seancave) vlerësohet me 6 pikë nëse dokumentet dhe leja dërgohen të plota, me 4 pikë nëse dërgohen me disa kufizime (p.sh. të anonimizuara); me 2 pikë nëse dërgohen me kufizime të mëdha (p.sh. vendimet dërgohen të anonimizuara dhe me shënimin që mund të përdoren vetëm për qëllime studimore ose gazetarit i lejohet ndjekja e seancës por jo fotografimi ose regjistrimi qoftë dhe i pjesshëm i saj) dhe me 0 pikë nëse kërkesa është refuzuar tërësisht ose nuk i është kthyer përgjigje nga ana e gjykatës.

Duke qenë se qëllimi kryesor i këtij monitorimi është vlerësimi i transparencës pro-aktive, pra i gatishmërisë së gjykatave për të publikuar informacionin e parashikuar në kuadrin rregullator si të detyrueshëm për publikim pa kërkesë paraprake nga qytetarët ose gazetarët, pikëzimi i indikatorëve i jep një rëndësi më të madhe publikimit të informacionit online, duke vijuar më pas me atë në terren dhe atij të ofruar përmes kërkesave për të drejtë informimi, siç mund të dallohet dhe nga tabela përmbledhëse më poshtë.

Tabela 3: Vlerësimi i indikatorëve.

Niveli i aksesit në dokumentacion/informacion	Pikët
Të publikuara në mënyrë të plotë online dhe të aksesueshme (të linkuara) përmes programit të transparencës	6
Të publikuara në mënyrë të plotë në faqe por të pa-aksesueshme (të pa-linkuara) përmes programit të transparencës	4
Të afishuara në stendë ose pranë ambienteve të gjykatës në mënyrë të plotë	4
Të publikuara në mënyrë të pjesshme në faqe	2
Të vëna në dispozicion pas kërkesës në terren në format hardcopy	2
Të vëna në dispozicion pas kërkesës për të drejtë informimi në format hardcopy	2
Të vëna në dispozicion pas kërkesës për të drejtë informimi në mënyrë të pjesshme	1
Dokumentacioni ekziston por refuzohet të vihet në dispozicion	0
Dokumentacioni nuk ekziston / nuk është hartuar	0

Ponderimi i Indikatorëve: Secili nga indikatorët e përzgjedhur për monitorim u ponderuan në bazë të peshës së tyre specifike nga 1 deri në 5, bazuar në rëndësinë e tyre në kuadër të vlerësimit të transparencës. Për shembull, publikimi i vendimeve gjyqësore ose i kalendarit të seancave janë ponderuar me 5, duke qenë se përbëjnë dhe dokumentacionin ose informacionin publik më të kërkuar nga qytetarët dhe që janë produkti kryesor i veprimtarisë dhe funksioneve të një gjykate. Nga ana tjetër, publikimi i strukturës së pagave të funksionarëve të gjykatës është ponderuar me 1, duke qenë se pavarësisht se është një kërkesë e lidhur me nenin 7 të Ligjit 119/2014 'Për të Drejtën e Informimit', ajo ka më pak peshë në kërkesën e llogarisë dhe transparencën e gjykatës ndaj publikut të gjerë. Njësitë e ponderimit (peshës specifike) për secilin indikator gjenden në Tabelën 4.

Analizimi i të dhënave: Pikët e vlerësimit të secilit indikator u ponderuan në bazë të rëndësisë së tij. Pikët maksimale të ponderuara të indikatorëve të secilës kategori formësojnë nivelin 100% të transparencës për kategorinë përkatëse, ndërsa pikët maksimale të ponderuara të të gjithë indikatorëve sëbashku përbëjnë nivelin

maksimal të transparencës (100%) për secilën gjykatë. Për shembull, niveli i transparencës së kategorisë “E Drejta e Informimit” të një gjykate përlogaritet duke përpjesëtuar pikët e ponderuara të gjashtë indikatorëve përbërës me numrin maksimal të pikëve të mundshme të transparencës për atë kategori. Në të njëjtën mënyrë, për të vlerësuar nivelin e përgjithshëm të transparencës, pikët e ponderuara të 36 indikatorëve përpjesëtohen me pikët maksimale të mundshme. Kjo mënyrë analizimi dhe paraqitjeje e gjetjeve të këtij monitorimi mundëson vlerësimin e nivelit të përgjithshëm të transparencës, por dhe kategorive specifike të indikatorëve në përqindje për secilën gjykatë.

Tabela 4: Indikatorët përbërës së secilës kategori dhe pesha specifike e secilit indikator.

Kategoria dhe Indikatorët përkatës	Pesha
Aksesi në gjykata	
Aksesi fizik në ambientet e gjykatës*	5
Formulari për video-regjistrimin nga ana e gazetareve	3
Formulari i kërkesës së regjistrimit audio	3
Kopje vendimi gjyqësor**	5
Kopje transkriptimi ose regjistrimi audio i një seance gjyqësore**	5
Leje për ndjekjen dhe regjistrimin e seancave**	5
Çështjet dhe vendimet gjyqësore	
Publikimi i vendimeve të gjykatës	5
Publikimi i listës së çështjeve në gjykim	5
Publikimi i kalendarit të seancave gjyqësore	4
Përmbledhje e ecurisë së çështjeve dhe kronologjisë	3
Statistika mbi çështjet / Evidenca statistikore	4

Informacion për publikun	
Publikimin e njoftimeve me afishim publik	3
Listën e tarifave të shërbimeve që ofron gjykata	3
Të drejtat e qytetarëve dhe orientimi në gjykata	2
Adresa e gjykatës dhe mundësi kontaktimi	2
Listën emërore të avokatëve, ekspertëve dhe ndërmjetësve të gjykatës	3
Organizimi i brendshëm	
Struktura organizative/ organograma e gjykatës	2
Funksionet dhe detyrat e funksionarëve të gjykatës	2
Listën emërore të gjyqtarëve	3
Strukturat e pagave të stafit të gjykatës	1
Rregulloret e miratuara dhe në fuqi të gjykatës	3
Raportin vjetor të gjykatës për vitin më të fundit të analizuar	2
CV/ Biografitë e funksionarëve të lartë	2
Kuadrin rregullator në fuqi mbi të cilat bazohet funksionimi	2
Transparenca Financiare	
Buxheti i vitit aktual	1
Raportin e monitorimit të shpenzimeve për vitin më të fundit financiar të analizuar	2
Raporti i fundit i auditimit të brendshëm	2
Raport i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose organe të tjera mbikqyrëse**	2
Lista e kontratave të lidhura momentalisht me palë të treta (shërbime të kontraktuara ose tenderuara)	2

Informacione mbi shumën e kontraktuar, palët kontraktuese, përshkrimi i mallrave ose shërbimeve të kontraktuara, plan zbatimi (afate kohore) dhe monitorimi të tyre.	2
E drejta e informimit	
Programi i transparencës së gjykatës	3
Koordinatori i të drejtës së informimit	3
Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit	3
Formati i kërkesës për informim	2
Formati i ankimit të vendimit përkatës për informacionin e kërkuar	2
Regjistri i kërkesave për të drejtën e informimit dhe përgjigjeve ndaj tyre	3

*Ky indikator u monitorua vetëm përmes vëzhgimit në terren dhe vlerësimi i tij kryhet sipas udhëzimeve të ofruara në seksionin e 'Vlerësimit të indikatorëve'

**Këta tre indikatorë u monitoruan vetëm përmes kërkesave për të drejtë informimi dhe vlerësimi i tyre kryhet sipas udhëzimeve të ofruara në seksionin e 'Vlerësimit të indikatorëve'

***Ky indikator u përjashtua nga pikëzimi final në rastet kur nuk ekzistonte, pra nëse një gjykatë nuk ka qenë asnjëherë subjekt i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ky indikator nuk u përfshi në përlogaritjen e nivelit të transparencës së përgjithshme ose kategorisë përkatëse.

Kufizime të metodologjisë: Metodologjia e përzgjedhur përmban disa kufizime. E para: monitoruesit e angazhuar në këtë vlerësim janë gazetarë, çka mund të ndikojë në gatishmërinë e institucioneve për të ofruar informacionin ose dokumentin e kërkuar gjatë vëzhgimit në terren ose përmes kërkesave për të drejtë informimi në krahasim me publikun e gjerë. E dyta: gjetjet e monitorimit i referohen vetëm periudhës specifike të realizimit të tij në terren dhe online.



MONITORIMI I NIVELIT TË TRANSPARENCËS SË GJYKATAVE NË SHQIPËRI

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Shqipëri
Tiranë, 2018